

FORMA TË SHUMËSIT NË RRAFSHIN E PLANIFIKIMIT GJUHËSOR TË SHQIPES

I.

Planifikimi gjuhësor dhe proceset standardizuese të gjuhës janë kërkesa që janë shtruar prej kohësh për diskutim para shkencës gjuhësore shqiptare. Për një problem të tillë ka pasur e vazhdon të ketë reagime nga më të ndryshmet, kryesisht sa u takon vlerësimeve që u janë bërë proceseve të shkuara.

Me kushtet e reja sociale, politike, ekonomike e kulturore gjuha, si çdo dukuri tjetër shoqërore, zhvillohet, ka tendencën të pasurohet duke arritur nivele më të përparuara.

Shqipja standard tashmë ka arritur në një stad më të ngritur të zhvillimit të saj, në stadin e modernizimit. Ajo tashmë po kërkon të plotësojë gjithnjë e më shumë nevojat e shkencës, të kulturës, të arsimit e të gjitha aspekteve të jetës shoqërore. Megjithatë vërehen edhe disa mangësi.

Situata e sotme kërkon që këto çështje të shihen me gjakftohtësi, larg tendencave ideologjike, lokaliste e krahinore, individuale apo imponuese, por nga ana tjetër është e domosdoshme që të bëhen edhe ndryshime e ndreqje të mundshme, mbasi “*edhe për gjuhët që kanë tradita më të vjetra, shtrohet kërkesa për përmirësime*”¹.

Idriz Ajeti dhe Emil Lafe vite më parë kanë theksuar se “*Gjuha shqipe ka sot një drejtshkrim të përcaktuar me të mirat, kundërthëniet dhe mangësitë e tij të pashmangshme, sikur edhe në shumë gjuhë të tjera*”².

Në këto rrethana studimi i veçorive gjuhësore të dialekteve, si prurje të rëndësishme për pasurimin e gjuhës, e në veçanti i gegërishtes, do të luante një rol të rëndësishëm për zhvillimin e standardit gjuhësor të shqipes, i cili ka nevojë të pasurohet më tej, gjë që pranohet edhe nga shumë studiues.

“*Pasuria gjuhësore e gegërishtes së bashku me rivlerësimet e mjaft shkrimtarëve të shquar që kanë shkruar në gegërisht, - thekson Anastas Dodi, - duhet të ketë një vend më të gjerë në gjuhën letrare dhe të bëhen pasuri e gjithë gjuhës shqipe.*”³

¹ Shaban Demiraj, në “Seminarin XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995, f.740.

² Idriz Ajeti – Emil Lafe, *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit*, “Studime filologjike”, 1998, nr.1-2, f. 12.

³ Anastas Dodi, në “Seminarin XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995, f.734.

Në kushte të tilla, gati 40 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, është mirë të diskutohen disa zgjidhje të dhëna për çështje të caktuara për të kryer përmirësimet e nevojshme. Një gjë të tillë, besojmë nuk mund ta mohojë askush, atë nuk e mohon as vetë “*Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe*”, në të cilën shënohej :

“Kongresi porositi që, duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj, si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore mbi drejtshkrimin, “Rregullave të drejtshkrimit” t’u bëhen në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura”.

Synimi kryesor yni duhet të jetë që të kryejmë një afrim sa më të madh të standardit me përdoruesin e tij, gjithmonë duke pasur parasysh që një gjë e tillë “*të realizohet duke bërë përpjekje për t’u hapur shtegun disa prirjeve që nuk shikohen as si shartime, as si sajime gjuhëtarësh, por që në realitet janë fakte të shqipes së folur e të shkruar.*”⁴

Standardi i sotëm, sidomos në këtë situatë të re dhe komplekse sociolinguistike të krijuar kohët e fundit, kushtëzuar sidomos nga ndryshimet demografike, sociale dhe ekonomike që ka pësuar e po pëson shoqëria shqiptare, ka nevojë të rishikohet si në rrafshin leksikor, ashtu edhe në atë gramatikor, në disa drejtime.

“Besoj, thekson akademiku Shaban Demiraj, se të gjithë jemi të vetëdijshëm se rregullat e drejtshkrimit duhen të pasurohen më tej... ato rregulla të thjeshtësohen në mënyrë të tillë që të bëhen më të kapshme dhe lehtësisht të zbatueshme”.⁵

Për vetë karakterin e kumtesës sonë ne do të ndalemi vetëm në një problem sa për të dëshmuar nevojën dhe mundësinë e ndërmarrjes së nismave për të studiuar e për të përmirësuar ato çështje që janë më problemore për drejtshkrimin e sotëm të gjuhës sonë.

II.

Një ndër problemet që është diskutuar në shtypin shkencor në këto 20 vjet, ka qenë edhe prirja që është vënë re në disa forma të shumësit të gjinisë mashkullore.

A. Më i prekshëm në këtë rrafsh ka qenë diskutimi i shumësit të emrave të kësaj gjinie, që në numrin njëjës dalin me zanore të theksuar ose me togun *-ua*, dhe marrin formantin *-nj*, si : *ari-nj*, *bari-nj*, *kalli-nj*, *hu-nj*, *mi-nj*, *dru-nj*, *hero-nj*, *patkua - patkonj*, *ftua - ftonj*, por edhe të atyre emrave që në shumës marrin

⁴ E.Hysa, *Rreth prirjeve në formimin e shumësit të disa emrave*, në “Seminarin ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 20/1, Prishtinë, 2001, f. 299-303.

⁵ Sh. Demiraj, *Shqipja e sotme letrare në prag të shekullit XXI*, “Gjuha jonë”, 1998, nr.1-4, f.24,

prapashtesën **-enj** dhe **-inj**, si: *lumë, shkëmb, budalla, fukara, prift, shkop* etj.

Edhe në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, më 1972, ndonëse shkurtazi, ka pasur kumtesa që kanë hedhur idenë për përgjithësimin e shumësit me **-j**.

Të ndalemi edhe në një fakt tjetër të asaj periudhe. Në parashtresën e komisionit të seksionit A, që u paraqit në Kongresin e Drejtshkrimit, ditën e katërt, në mes tjerash, thuhej:

*“Në lidhje me shumësin me **-nj** ose me **-j** të emrave ose të mbiemrave, u vu në dukje se në gjuhën letrare të shkruar e të folur, trajta me **-nj** është mbizotëruesja, por duke marrë parasysh shtrirjen e gjerë dialektore të mbaresës **-j**, u propozua që edhe kjo rregull të rishikohet, duke qenë se vihet re edhe një prirje e gjallë për mbaresën **-j**.”⁶*

Edhe rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit e lë shtegun pothuajse të hapur kur thotë :

*“Të ruhet bashkëtingëllorja **-nj-** në trup të fjalës te emrat brinjë, shkronjë etj. dhe të përcaktohet norma në mbaresën e shumësit me **-nj** ose me **-j** për emrat e tipit ari, bari, ulli, ftua, përrua etj., si dhe për mbiemrat e tipit të ri. Zgjidhjet të jenë në pajtim me prirjet e zhvillimit të strukturës fonetike dhe morfologjike të shqipes letrare.”*

Pra, siç shihet, edhe 38 vjet më parë rezoluta zgjidhjen e këtij problemi nuk e ka mbyllur plotësisht. Edhe pas botimit të Rregullave të Drejtshkrimit të vitit 1973 ka pasur shkrime për këtë shumës. Dy vjet më pas Mehmet Çeliku, ndonëse shumë shkurt, kërkon mënjanimin e shkrimit të **nj**-së në fund të fjalëve tek shumësi i emrave mashkullorë, duke parapëlqyer trajtën me **-j** (*barij, heroj, lumej* etj.), po ashtu edhe mënjanimin e **nj**-së në raste të tjera te disa mbiemra etj. Këtë zgjidhje autori e sheh *si afrimi më i madh i drejtshkrimit me drejtshqiptimin e sotëm në përgjithësi, por edhe me drejtshkrimin verior në veçanti*⁷.

Ky tip shumësi është prekur edhe nga Enver Hysa, që e mbështet mendimin e tij në tre tregues:

1. Zhvillimi gjuhësor ka çuar në mënyrë të natyrshme në kalimin nga formanti **-nj** në formantin **-j** në gjithë sistemin foljor, duke mos lënë shteg për asnjë përjashtim;
2. Përjashtimi i ndonjë shumësi, duke rekomanduar përdorimin me **-j**, ka ardhur si rezultat i një prirjeje të shqipes në rrafshim të **-nj**-së në

⁶ *Parashtesa e komisionit të seksionit A në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, Tiranë, 1973, f.142. Shih edhe: Parashtresë e komisionit të seksionit B. në “Kongresi...”. Aty shënohet: “Të vështrohet më tej çështja e shumësit me -nj të emrave, si: ullinj, ftonj, barinj për të cilët pati edhe kërkesa që të shkruhen me -j.”*

⁷ M. Çeliku, *Probleme të diskutueshme rreth Drejtshkrimit të gjuhës shqipe të vitit 1973*, në “Seminarin XV për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995, f.217.

- j**, ashtu siç ngjet në sistemin foljor, gjë që është vënë re edhe nga hartuesit e rregullave të drejtshkrimit;
3. Duke u mbështetur në parimin fonetik, të zbatuar nga drejtshkrimi aktual, gjuha e folur pas kaq vitesh i jep të drejtë shtrirjes së përdorimit të formantit **-j** në vend të **-nj-së**⁸.

Ky shumë është trajtuar edhe nga gjuhëtarë të tjerë⁹.

E ringrejmë këtë problem, duke u mbështetur edhe në këto argumente :

1. Ky formant ka filluar të lëkundet në ligjërimin e folur jo vetëm në Veri, por edhe në Jug. Për këtë qëllim ne kemi parë disa studime dialektore të botuara kohë më parë. Vërehen lëkundje në zonën e Kurveleshit, Devollit, Zagorisë, Fushë-Korçës, në Bregdetin e Poshtëm etj. Në shkrimin “*Vëzhgime rreth të folmes së Kurveleshit*”, autori i saj, Menella Totoni, në mes të tjerash, shkruan : “*Në shumësin e emrave -nj-ja nuk ka dhënë gjithkund -j, sidoqoftë rastet ku -nj-ja ka përfunduar në -j janë më të shumta, si: kallij, thoj, mij, shkopij, lumej*”.¹⁰
2. Praktika gjuhësore po na bind se përdorimi i mbaresës **-j** në kohën e tashme të mënyrës dëftore : *punonj / punoj, lexonj / lexoj, mësonj / mësoj* është asimiluar pa vështirësi edhe nga shqipfolësi i Jugut.
3. Përdorimi i emrave të vepruesit me **-ues** në dëm të emrave me mbaresën **-nj, si** : *dëgjonjës / dëgjues, lexonjës / lexues, mësonjës / mësuës* etj. vazhdon të përdoret normalisht.
4. Pranimi i ndonjë përjashtimi nga rregulli, si i fjalëve : *kufij, kalamaj, të këqij*, është një faktor që e mbështet mendimin tonë. Në këtë replikë mendojmë se është më i përligjur sot përdorimi i formantit **-j** në dëm të **-nj-së**.
5. Tradita drejtshkrimore, mbështetur në drejtshkrimin e vitit 1948, 1951 dhe 1956 nuk i ka dhënë përparësi vetëm formantit **-nj**, por e ka pranuar si dysi drejtshkrimore së bashku me formantin **-j**, ndërsa në projektin e vitit 1967 dhe në drejtshkrimin e vitit 1973 nuk pranohet si dysi drejtshkrimore, por rekomandohet formanti **-nj**. Në Fjalorin e vitit 1954 vëmë re se varianti i shumësit me **-nj** në krahasim me atë me **-j** paraqitet në raportin 2/1¹¹, çka do të thotë se për shumë kohë kanë mbijetuar të dy variantet, por më pas është

⁸ E. Hysa, *Rreth prirjeve në formimin e shumësit të disa emrave*, në “Seminarin XX për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2002, f. 301-302.

⁹ T. Osmani, *Për një përputhje të shumësit të emrave, në veçanti të raportit njëj drejtshkrim-drejtshqiptim në standardin e sotëm*, në “Seminarin XX për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2006, f. 259-264; M. Halimi, *Rreth shumësit të disa emrave mashkullorë*, në “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”, Tiranë, 2002, f. 141.

¹⁰ M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmes së Kurveleshit*, “Dialektologjia shqiptare, 1, 1971, f.49.

¹¹ Shih : M. Trepça, *Rreth drejtshkrimit të -j-së në gjuhën letrare shqipe*, në “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, II, Tiranë, 1973, f.172

ndërprerë zhvillimi normal i kësaj dukurie, duke përgjithësuar varianti e parë.

6. Mendojmë se formanti **-j** ka një territor më të gjerë përdorimi në hapësirën shqipfolëse në raport me **-nj**.
7. Përdorimi i këtyre emrave në rasën emërore dhe në rasat e zhdrejta të shumësit krijon vështirësi në artikullim dhe në shqiptim, si: *thonj / thonjve, minj / minjve, hu / hunjve* etj.
8. Ndryshimet, që mund të ndodhin në gjuhë, grupmoshat e reja e kanë prirjen t'i thithin më shpejt, pasi në shumicën e rasteve nuk janë konservatorë të ligjërit të prindërve të tyre, por ndikohen edhe nga faktorë të tjerë, si : shkolla, media e shkruar dhe e folur etj.

Prandaj, mbështetur në argumentet e mësipërme, mendojmë se për këtë kategori emrash ka ardhur koha që të rivështrohet një rregull i tillë, për t'u ligjëruar shumësi me formantin **-j**.

B. Një shumës që për mendimin tonë, mbetet edhe sot i diskutueshëm është edhe ai i gjinisë mashkullore i formuar me formantin **-a**. Ky shumës, siç dihet, ka një përhapje të gjerë në të folmet gege, por nuk përjashtohet edhe përdorimi në ato jugore. Në një shkrim me karakter dialektologjik për të folmen e Tomoricës, theksohej se shumë emra të gjinisë mashkullore e formojnë shumësin me formantin **-a**, si: *mësuesa, inxhiniera, oficera, bilbila, çengela* etj.¹²

Këtë shumës e ndeshim edhe në të folme të tjera, në disa raste në grupe fjalësh të veçanta, si në të folmet e Myzeqesë, të Semanit, të Devollit etj. Janë shumë të shpeshta rastet e shumësit me **-a** të këtyre fjalëve : *oficera, shofera, nxënësa, studenta, doktora, nënpunësa, bilbila* etj. Forma të tilla drejtshkrimi ynë nuk i pranon, ndërkohë që në përdorimin e përditshëm, e jo vetëm në të folur, ato kanë fituar të drejtën e qytetarisë.

Të ndalemi edhe në disa raste të tjera apo dysi drejtshkrimore që kanë nevojë të vëzhgohen dhe të studiohen më tej për t'i dhënë një zgjidhje sa më të pranueshme.

I diskutueshëm mbetet edhe shumësi i fjalëve *dokumente, argumente, instrumente*, ku trajtat e mëparshme *dokumenta, argumenta, instrumenta* janë mënjanuar nga drejtshkrimi i sotëm. Në shqipen e sotme nuk vëmë re ndonjë prirje të zhvillimit të formantit **-e**, ndërkohë që në median e shkruar e të folur po ndeshim përherë e më tepër përdorimin e shumësit me **-a** në këtë kategori fjalësh, p.sh. : *dokumenta - Shumë kujtime, shkrime e*

¹² H. Xhaferi, *E folmja e Tomoricës*, "Dialektologjia shqiptare", 6, Tiranë, 1990, f.344.

dokumenta i referohen kësaj pjese interesante dhe të pazbuluar deri sot. (Gazeta shqiptare, Milosao, 28.11.2010, f.II)

Ne jemi të mendimit që edhe ky shumës duhet parë, ndoshta edhe duke bërë diferencime në mes grupe fjalësh, ku vihet re një gjallërim i një shumësi të tillë me formantin **-a**, veçanërisht në disa stile përdorimi.

Gjithashtu mendojmë se edhe disa dysi drejtshkrimore mund të zgjidhen në të mirë të formantit **-a**, si : *gishta / gishtërinj, xhama / xhame* etj., mbasi në letërsinë artistike, por edhe në publicistikë përparësi po i jepet shumësit me **-a**, si :

Kishte kujtuar se do t'i haptet gishtat në çast (I.Kadare, E penguara, Requiem për Linda B., Tiranë, 2009, f.11)

...edhe pse unë zura t'i imitoja gishtat e saj, duke mbledhur gishtat e secilës dorë... (A.Tufa, Mërkuna e zezë, Tiranë, 2005, f.14)

...doli një tjetër pas xhamave andej dhe prapsi turmën që qe afruar ca si shumë. (V.Zhiti, Perëndia mbrapsht dhe e dashura, Tiranë, 2004, f.13)

Për të gjitha këto që parashtroam më sipër, kemi mendimin se ka ardhur koha jo vetëm të diskutojmë, por të gjejmë edhe rrugën e zgjidhjes, duke bërë studime (disa me afat të shkurtër e disa me afat të gjatë) me qëllim që të realizojmë një afrim sa më racional, shkencor dhe objektiv të ligjërimit të folur me atë të shkruar.

Konferenca shkencore

“Shqipja në etapën e sotme : politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”

Durrës, më 15 - 17. 11. 2010